



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës:

Datë: 23.08.2022

Numri i dokumentit: 03354325

C.nr.1014/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala, dhe me pjesëmarrjen e praktikantes Miranda Ibrahim, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses E. Sh. nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit zëvendësues e përfaqëson i autorizuari Q. A., praktikant në zyrën e Av. Korab Bokshi nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson i autorizuari Dardan Bakija, për kompensimin e shpenzimeve për ushqim dhe të udhëtimit, vlera e kontestit 717,50 € , pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të autorizuarit të paditëses dhe në prani të përfaqësuesit të paditurës, me datën 12 gusht 2022, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses E. Sh. nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses së lartcekur, të i'a paguaj:

- në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore 07.03.2019 e deri me datë 31.05.2020, respektivisht për 175 ditë të pranisë në punë, shumën prej 350.00 euro si dhe
- në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në vendin e punës 07.03.2019 e deri me datë 31.05.2020, respektivisht për 175 ditë të pranisë në punë, shumën prej 367.50 euro,

në shumën e përgjithshme 717.50 euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila rrjedh nga data 07.07.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura që paditëseve t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme 269.40 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimit i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

## A s y e t i m

Paditësja E. Sh. nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 07.06.2021 përmes të autorizuarit të saj, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, duke theksuar se paditësja është e punësuar të e paditura përkatësisht në SHFMU "Hamëz Cena" në fshatin Damjan, komuna e Gjakovë. I autorizuari i paditëses, me parashtrësën e datës 11.08.2022 e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke kërkuar që paditësja për periudhën kohore nga data 07.03.2019 e deri më datë 31.05.2020 ka vijuar 175 ditë të pranisë në punë, ashtu që bazuar në kontratën Kolektive Arsimit të njëjtës i takojnë 2 euro në ditë në emër të shpenzimeve të ushqimit, të cilat e paditura deri me tani nuk i ka paguar. Për faktin se paditësja jeton në Gjakovë, ndërsa punon në fshatin Demjan, komuna e Gjakovës, të njëjtës bazuar në nenin 35 par. 5 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, i takon 70% i çmimit të biletës së trafikut urban, pasi që e njëjta për çdo ditë puneu ka udhëtuar nga vendbanimi i saj për në vend punimin e saj. Andaj mbi këtë bazë i njëjti në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesore dhe në fjalën e tij përfundimtare i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadija e precizuar e paditëses të aprovohet si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses se lartë cekur, në emër të shpenzimeve të udhëtimit 175 ditë të pranisë në punë të ia paguaj shumën prej 367.50 euro, ndërsa në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për të njëjtat ditë të pranisë në punë, të i'a paguaj shumën prej 350.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 717.50 euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Tutje ka shtuar se e kundërshton përgjigjen në padi të së paditurës dhe parashtrësën e datës 07.07.2022, duke theksuar se e njëjta është deklarative dhe nuk përmban asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e cekura.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë: atë për taksë gjyqësore 30,00 €, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 € dhe për pjesëmarrjen në dy seanca, shumën 270.40 €, shumën e përgjithshme prej 404.40 €.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi, në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën e tij përfundimtarë ka deklaruar se kontrata kolektive e arsimit e nënshkruar në mes të MASHT-it të dt. 22.01.2021 në nenin 47 të saj, ka shfuqizuar kontratën kolektive të dt. 18.04.2017, ashtu që sipas nenit 35 par. 7 të kësaj kontrate si dhe lidhur me këtë dhe dispozitat kalimtare të nenin 45 par. 1 nuk është bërë kurrfarë ndihmese në planifikimin e buxhetit për realizimin e kërkesave lidhur me zbatimin e dispozitave të nenit 35 par. 7,5 deri sa të krijohen mundësit financiare në Buxhetin e R. Kosovës por jo ma vonë se viti 2023, po ashtu edhe sipas Qarkores Buxhetore 2022/01 i dt. 14.05.2021, te granti specifik të arsimit para universitar, nuk është paraparë mundësia për realizimin e kësaj të drejte. Sa i përket parashtrësës së datës 11.08.2022, të parashtruar nga i autorizuari i paditëses me të cilën e ka precizuar kërkesë padinë, të njëjtën nuk e ka kundërshtuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor-publik ku dhe administroi këto prova: Kontratat e punës të lëshuar nga Komuna e Gjakovës në versionin e fotokopjuar e vërtetuar me nr. të Kontratës 23-311/2019 dhe 23/45/2020, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Hamëz Cena”, në fsh. Demjan 1, Komuna Gjakovës, me nr. të protokollit nr. 116/2022, dt. 06.07.2022, Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e transportit të udhëtarëve, Certifikata e vendbanimit me nr. B10325595 të lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në Gjakovë.

Nga Kontrata e punës e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, të vërtetuara me nr. 23-311/2019 dhe 23/45/2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja E. Sh. është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, respektivisht në Institucionin Arsimor: Shkolla “Hamëz Cena” në fshatin Damjan, Komuna e Gjakovës.

Nga Certifikata e vendbanimit me numër B10325595 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja E. Gola e ka vendbanimin në Gjakovë, rr. ”Dëshmorët e Lirisë” Nr. 21.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, për relacionin Gjakovë –Demjan, gjykata ka vërtetuar faktin se çmimi i biletës së trafikut në relacionin Gjakovë Demjan në një drejtim është 1.50 euro.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Hamëz Cena” në fshatin Demjan, Komuna e Gjakovës, me numër të protokollit 116/2022, i datës. 06.07.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se për periudhën kohore nga data 07.03.2019 e deri me datë 31.05.2020 e njëjta ka realizuar 175 ditë të pranisë në vendin e punës.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (më tutje LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridikë kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ajo e viti 22.01.2021, sepse kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punës për vitin 2020 mbulohet nga kontrata kolektive e datës 18.04.2017 e ndërsa pjesa tjetër për vitin 2021, mbulohet me kontratën kolektive të datës 22.01.2021.

Ne nenin neni 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr.01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës 01/B e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, në mënyrë identike parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.* Gjykata nga administrimi i provave të cilave prova dhe ja fali besimin e plot, gjeti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në

Shkollën Fillore” Hamëz Cena” fshati Damjan, komuna e Gjakovës, dhe për periudhën nga data 07.03.2019 e deri me datë 31.05.2020 në këtë institucion arsimorë ka vijuar 175 ditë të pranisë në punë, provuar sipas vërtetimit të lëshuar nga SHFMU ”Hamëz Cena” i dt. 06.07.2022. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëses nuk i’u ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me dispozita ligjor të lartëcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë që, ditët e kaluara në punë të paditëses, i ka shumëzuar me 2, duke i’au njohur shumën prej 350,00 euro.

Në anën tjetër në nenin 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe të asaj të datës 22.01.2021 në mënyrë identike është paraparë që është paraparë se: *“Mësimdhënësit që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Pasi që nga provat e administruara, të cilave prova gjykata i’u fali besimin, u konstatua se paditësja është e punësuar në SHFMU” Hamëz Cena” fshati Demjan, komuna e Gjakovës, dhe e njëjtat për periudhën kohore nga data 07.03.2019 e deri më datë 31.05.2020 ka vijuar 175 ditë të pranisë në punë, dhe se gjatë kësaj kohe vendbanimin e ka pasur në Gjakovë. Lartësinë e kërkesëpadiës lidhur me këtë kriter të kompensimit, gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit në Gjakovë, ku lartësia e çmimit të biletës kthye për relacionin Gjakovë-Demjan është 3,00 euro në ditë. Andaj, duke pasur parasysh që e paditura, paditëses nuk i’au kanë paguar shpenzimet e udhëtimit të parapara me dispozita ligjor të lartëcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses edhe për këtë kriter të kompensimit është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë që, ditët e kaluara në punë të paditëses i ka shumëzuar me 70% të çmimit të biletës së trafikut urban në relacionin ku e njëjta ka udhëtuar duke u’a njohur shumën prej 367.50 euro.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënësit dhe punëmarrësit të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen*

e tij”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorëve, përkatësisht këtu paditëses në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, pretendimet e të paditurës se nuk ka linjë buxhetore i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësja në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe ajo e viti 2021 kurse mungesa e buxhetit të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosje ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç ‘rast paditëseve i’u pranua shume e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 269.40 €. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 30,00 € ( e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 €, si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve në një seancë, shuma në vlerë prej 135,20 € të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës), duke mos ia njohur shumën prej 135.20 euro për përfaqësim në seancën e datës 12.08.2022, kjo pasi shpërblimi për punën e bërë në këtë rast për përfaqësim i takon vetë të autorizuarit i cili është avokat, ndërsa në këtë seancë ka prezantuar praktikanti në zyrën e avokatisë.

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr 1014/21 datë 12 gusht 2022.

Gj y q t a r j a,  
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.